



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.qbz.gov.al

Nr. 173

31 tetor

2013

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Vendim i KM nr. 960, datë 25.10.2013	Për krijimin e drejtorive të bujqësisë..... 7557
Vendim i KM nr. 961, datë 25.10.2013	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 205, datë 13.4.1999 të Këshillit të Ministrave “Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor”, të ndryshuar..... 7558
Urdhër i KM nr. 199, datë 26.10.2013	Për një shtesë në urdhrin nr. 202, datë 16.12.2005 të Kryeministrit “Për forcimin e transparencës, nëpërmjet rritjes së përdorimit të internetit dhe përmirësimit të faqeve ekzistuese të internetit”..... 7571
Vendim i BSH nr. 57, datë 11.9.2013	Për miratimin e rregullores “Për këmbimin e kartëmonedhave dhe monedhave shqiptare të dëmtuara”..... 7573

VENDIM
Nr. 960, datë 25.10.2013

PËR KRIJIMIN E DREJTORIVE TË BUJQËSISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 7 të ligjit nr. 90/2012, datë 27.9.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore” dhe të ligjit nr. 119/2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e 13-të drejtorive të bujqësisë (DB), në varësi të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, sipas fushës së veprimit, si më poshtë vijon:

- Drejtoria e Bujqësisë Berat, për rrethet Berat, Kuçovë dhe Skrapar;
- Drejtoria e Bujqësisë Dibër, për rrethet Dibër, Mat dhe Bulqizë;
- Drejtoria e Bujqësisë Durrës, për rrethet Durrës dhe Krujë;
- Drejtoria e Bujqësisë Elbasan, për rrethet Elbasan, Gramsh, Peqin dhe Librazhd;
- Drejtoria e Bujqësisë Fier, për rrethet Fier dhe Mallakastër;
- Drejtoria e Bujqësisë Lushnjë, për rrethin e Lushnjës;
- Drejtoria e Bujqësisë Gjirokastrë, për rrethet Gjirokastrë, Tepelenë dhe Përmet;
- Drejtoria e Bujqësisë Korçë, për rrethet Korçë, Pogradec, Kolonjë dhe Devoll;
- Drejtoria e Bujqësisë Kukës, për rrethet Kukës, Tropojë dhe Has;
- Drejtoria e Bujqësisë Lezhë, për rrethet Lezhë, Mirditë dhe Kurbin;
- Drejtoria e Bujqësisë Shkodër, për rrethet Shkodër, Malësi e Madhe dhe Pukë;
- Drejtoria e Bujqësisë Tiranë, për rrethet Tiranë dhe Kavajë;
- Drejtoria e Bujqësisë Vlorë, për rrethet Vlorë, Sarandë dhe Delvinë.

2. Drejtoritë e bujqësisë janë struktura administrative të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, të cilat krijohen për të ushtruar dhe ndjekur në territorin përkatës detyrat dhe kompetencat që rrjedhin nga zbatimi i politikave të përgjithshme të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave.

3. Strukturat dhe organikat e drejtorive të bujqësisë miratohen me urdhër të Kryeministrit.

4. Efektet financiare për zbatimin e këtij vendimi përballohen nga fondet e parashikuara në buxhetin e miratuar për Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave.

5. Vendimi nr. 95, datë 13.2.2003 i Këshillit të Ministrave “Për krijimin në qarqe të drejtorive rajonale të bujqësisë, ushqimit dhe mbrojtjes së konsumatorit”, shfuqizohet.

6. Ngarkohet Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



VENDIM
Nr. 961, datë 25.10.2013

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 205, DATË 13.4.1999 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR DISPOZITAT ZBATUESE TË KODIT DOGANOR”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 8449, datë 27.1.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në pjesën I, kreu I, titulli II të vendimit nr. 205, datë 13.4.1999 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Neni 3 ndryshohet si më poshtë vijon:

“Neni 3

Organika e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave është 1002 punonjës, të shpërndarë në nivel qendror dhe vendor. Struktura organike e administratës doganore është sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”.

2. Pika 1 e nenit 4 ndryshohet si më poshtë vijon:

“1. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave organizohet në 4 departamente:

- a) Departamenti Administrativ;
- b) Departamenti i Akcizës;
- c) Departamenti Teknik;
- ç) Departamenti Operativ dhe Hetimor.”.

3. Pika 3 e nenit 4.1 ndryshohet si më poshtë vijon:

“3. Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit, që përbëhet nga sektorët e mëposhtëm, të cilëve u janë caktuar përgjegjësitë kryesore, si më poshtë vijon:

a) Sektori i sistemeve dhe i sigurisë

Ky sektor ofron mbështetje operative dhe mirëmbajtje në nivel qendror e lokal për të maksimizuar disponueshmërinë e infrastrukturës dhe shërbimeve të teknologjisë së informacionit. Ky sektor siguron konsulentë dhe ndihmë të vazhdueshme teknike për stafin e teknologjisë së informacionit në degët doganore dhe ofron kornizat arkitektonike të ndërtimit të sistemit për të maksimizuar efikasitetin në mjedisin e teknologjisë së informacionit e të komunikimit. Me anë të aplikimit të politikave të sigurisë e të kanaleve të komunikimit, ky sektor realizon integritetin dhe administrimin e sistemeve informatike, me qëllim mbrojtjen nga sulmet për dëmtimin e sistemeve të kompjuterizuara të administratës doganore shqiptare.

b) Sektori i zhvillimit

Ky sektor administron projektimin, zhvillimin, implementimin dhe mirëmbajtjen e zgjidhjeve të teknologjisë së informacionit për t’u përdorur nga shërbimi doganor dhe bisnezi, si dhe jep këshilla për planifikimin, projektimin, zhvillimin dhe implementimin e shërbimeve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit për të ardhmen. Gjithashtu, ai ofron zgjidhje për informatizimin e të gjitha proceseve të punës në administratë, duke përdorur programe të gatshme, duke integruar zgjidhje të ndryshme dhe duke zhvilluar (programuar) zgjidhje origjinale aty ku është e nevojshme.

c) Sektori i zgjidhjeve dhe i suportit

Ky sektor ofron angazhimin për biznesin, menaxhim projektesh dhe shqyrtimin e aktiviteteve të teknologjisë së informacionit dhe është një pikë e vetme e hyrjes për biznesin për shërbimet e ofruara nga Departamenti i Teknologjisë së Informacionit. Ky sektor ofron shërbimin Help Desk me anë të e-mail-it ose telefonit për probleme të ndryshme që lindin gjatë përdorimit të sistemeve informatike doganore, delegon problemin në sektorët apo drejtoritë përkatëse, kur për zgjidhjen e tij kërkohet ndërhyrje më e specializuar, si dhe bashkërendon punën ndërmjet strukturave të përfshira në këto zgjidhje.

ç) Sektori i analizave

Ky sektor ka për detyrë mbledhjen e të dhënave për lëvizjen e mallrave shqiptare dhe joshqiptare, që hyjnë e dalin nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë, analizimin e të dhënave, objekt të vlerësimit nga zyrat e interesuara dhe autoritetet publike, në përputhje me legjislacionin në fuqi.”.

4. Neni 4.3 shfuqizohet.

5. Pas pikës 7.4 të nenit 7 shtohet pika 7.5, me këtë përmbajtje:

“7.5. Drejtoria e Buxhetit dhe Financës, që përbëhet nga:

a) Sektori i buxhetit;

b) Sektori i financë-kontabilitetit.

Kjo drejtori kryen analizat financiare dhe të bilancit, përgatit planin vjetor të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe të përdorimit të burimeve financiare, mban kontabilitetin, shpërndan e jep fondet e nevojshme për funksionimin e zyrave qendrore e vendore dhe për pagimin e personelit doganor dhe administron dhënien e pagave e të shpërblimeve të tjera shtesë të personelit të Drejtorisë së Përgjithshme.”.

II. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



Lidhja nr. 1

Emertimi i postit		Kodi Zyres	Funksioni	Kategoria	Nr. Puno njesve	Kate goria Pages
Kabineti Drejtorit te Pergjithshem		1000	Drejtor i Përgjithshëm	II-a	1	II-a
			Keshilltar	A	1	III-a
			Keshilltar per Inovacionin	A	1	III-a
			Keshilltar per Komunikimin	A	1	III-a
			Keshilltar per Projektet	A	1	III-a
			Sekretare/Asistente	C2	1	IV-a
Totali Kabinetit					6	
Drejtoria Marredhenieve me Jashte dhe me Publikun		1400	Drejtor Drejtorie	A	1	III-a
			Specialist i marredhenieve nderkombetare	C1	1	III-b
			Perkthyes	C1	1	III-b
			Specialist per marredheniet me shtypin dhe publikun	C1	1	III-b
			Specialist per menaxhimin e projekteve	C1	1	III-b
Totali Drejtorise					5	
Drejtoria Auditimit Brendshem		1500	Drejtor Drejtorie	A	1	III-a
			Specialist auditi	C1	7	III-b
Totali Drejtorise					8	
Drejtoria e Investigimit te Brendshem dhe Antikorupsionit		1530	Drejtor Drejtorie	A	1	III-a
			Specialist	C1	4	III-b
Totali Drejtorise					5	
Drejtoria e Buxhetit dhe Finances		1140	Drejtor Drejtorie	A	1	III-a
		Sektori buxhetit	1141	Pergjegjes Sektori	B	1
			Specialist	C1	2	III-b
	Sektori Finance/kontabilitetit	1142	Pergjegjes Sektori	B	1	III-a/1
			Specialiste	C1	1	III-b
			Llogaritar/Specialist i nivelit te dyte	C2	5	IV-a
			Magazinjer	D1	2	
Totali Drejtorise					13	
Kabineti Drejtorit te Pergjithshem					37	
Departamenti Teknik		1200	Zv/Drejtor i Përgjithshëm		1	II-b
			Sekretare	C3	1	
Total					2	
Drejtoria Procedurave, Kontrollit te Pagesave dhe Garancive Doganore		1210	Drejtor Drejtorie	A	1	III-a
		Sektori Procedurave	1211	Pergjegjes Sektori	B	1
			Specialist	C1	4	III-b
	Sektori i Kontrollit te Pagesave dhe Garancive Doganore	1212	Pergjegjes Sektori	B	1	III-a/1
			Specialist	C1	2	III-b
		Specialist I Nivelit te dyte	C2	1	IV-a	
Totali Drejtorise					10	
Drejtoria Origjinës, Tarifes dhe TVSH-se		1220	Drejtor Drejtorie	A	1	III-a
		Sektori i Tarife,TVSH	1221	Pergjegjes Sektori	B	1
			Specialist	C1	3	III-b
	Sektori Origjinës	1222	Pergjegjes Sektori	B	1	III-a/1
Specialist			C1	3	III-b	
Totali Drejtorise					9	
Drejtoria Juridike		1230	Drejtor Drejtorie	A	1	III-a
		Sektori legjislacioniit dhe Perafrimit BE	1231	Pergjegjes Sektori	B	1
			Specialist legjislacioni	C1	3	III-b
	Sektori i Ankimimeve	1232	Pergjegjes Sektori	B	1	III-a/1
Specialist jurist			C1	5	III-b	
Totali Drejtorise					11	
Drejtoria e Laboratorit Doganor		1250	Punonjes Pastrimi	D3	1	
		Sektori standarteve, metodikave dhe administrimit	1251	Pergjegjes Sektori	B	1
			Specialist laborante	C1	2	III-b
	Sektori analizave	1252	Pergjegjes Sektori	B	1	III-a/1
			Specialist laborante	C1	6	III-b
		Asistentë laborante	C2	6	IV-a	
Totali Drejtorise					18	

Lidhja nr. 1

Emertimi i postit		Kodi Zyres	Funksioni	Kategoria	Nr. Puno njesve	Kate goria Pages
Kabineti Drejtorit te Pergjithshem		1000	Drejtor i Përgjithshëm	II-a	1	II-a
			Keshilltar	A	1	III-a
			Keshilltar per Inovacionin	A	1	III-a
			Keshilltar per Komunikimin	A	1	III-a
			Keshilltar per Projektet	A	1	III-a
Sekretare/Asistente			C2	1	IV-a	
Totali Kabinetit					6	
Drejtoria Marredhenieve me Jashte dhe me Publikun		1400	Drejtor Drejtorie	A	1	III-a
			Specialist i marredhenieve nderkombetare	C1	1	III-b
			Perkthyes	C1	1	III-b
			Specialist per marredheniet me shtypin dhe publikun	C1	1	III-b
			Specialist per menaxhimin e projekteve	C1	1	III-b
Totali Drejtorise					5	
Drejtoria Auditimit Brendshem	1500	Drejtor Drejtorie	A	1	III-a	
		Specialist auditit	C1	7	III-b	
Totali Drejtorise					8	
Drejtoria e Investigimit te Brendshem dhe Antikorrupsionit		1530	Drejtor Drejtorie	A	1	III-a
			Specialist	C1	4	III-b
Totali Drejtorise					5	
Drejtoria e Buxhetit dhe Finances	Saktori buxhetit	1140	Drejtor Drejtorie	A	1	III-a
		1141	Pergjegjes Saktori	B	1	III-a/1
			Specialist	C1	2	III-b
	Pergjegjes Saktori		B	1	III-a/1	
	Specialiste		C1	1	III-b	
	Saktori Finance/ kontabilitetit	1142	Llogaritar/Specialist i nivelit te dyte	C2	5	IV-a
			Magazinjer	D1	2	
Totali Drejtorise					13	
Kabineti Drejtorit te Pergjithshem					37	
Departamenti Teknik		1200	Zv/Drejtor i Pergjithshem		1	II-b
			Sekretare	C3	1	
Total					2	
Drejtoria Procedurave, Kontrollit te Pagesave dhe Garancive Doganore	Saktori Procedurave	1210	Drejtor Drejtorie	A	1	III-a
		1211	Pergjegjes Saktori	B	1	III-a/1
	Specialist		C1	4	III-b	
	Saktori i Kontrollit te Pagesave dhe Garancive Doganore		1212	Pergjegjes Saktori	B	1
		Specialist		C1	2	III-b
Specialist I Nivelit te dyte			C2	1	IV-a	
Totali Drejtorise					10	
Drejtoria Origjines, Tarifes dhe TVSH-se	Saktori i Tarife,TVSH	1220	Drejtor Drejtorie	A	1	III-a
		1221	Pergjegjes Saktori	B	1	III-a/1
			Specialist	C1	3	III-b
	Saktori Origjines	1222	Pergjegjes Saktori	B	1	III-a/1
			Specialist	C1	3	III-b
Totali Drejtorise					9	
Drejtoria Juridike	Saktori legjislaconit dhe Perafrimit BE	1230	Drejtor Drejtorie	A	1	III-a
		1231	Pergjegjes Saktori	B	1	III-a/1
	Specialist legjislaconi		C1	3	III-b	
	Saktori i Ankimimeve	1232	Pergjegjes Saktori	B	1	III-a/1
			Specialist jurist	C1	5	III-b
Totali Drejtorise					11	
Drejtoria e Laboratorit Doganor		1250	Drejtor Drejtorie	A	1	III-a
			Punonjes Pastrimi	D3	1	
	Saktori standarteve, metodikave dhe administrimit	1251	Pergjegjes Saktori	B	1	III-a/1
			Specialist laborante	C1	2	III-b
	Saktori analizave	1252	Pergjegjes Saktori	B	1	III-a/1
			Specialist laborante	C1	6	III-b
			Asistente laborante	C2	6	IV-a



Lidhja nr. 1

Emertimi i postit		Kodi Zyres	Funksioni	Kategoria	Nr. Puno njesve	Kate goria Pages
Totali Drejtorise					18	
Drejtoria Vleres Doganore						
		1260	Drejtor Drejtorie	A	1	III-a
	Sektori Mbikqyerjes se Vleres Doganore	1261	Pergjegjes Sektori	B	1	III-a/1
			Specialiste	C1	2	III-b
	Sektori i te dhenave te disponueshme	1262	Pergjegjes Sektori	B	1	III-a/1
			Specialist	C1	2	III-b
Totali Drejtorise					7	
Totali I Departamentit Teknik					57	
Departamenti Akcizes		1600				
			Zv/Drejtor i Pergjithshem	II-b	1	II-b
			Sekretare	C3	1	
Total					2	
Drejtoria e Teknike e Akcizes		1610	Drejtor Drejtorie	A	1	III-a
	Sektori i Autorizimeve	1611	Pergjegjes Sektori	B	1	III-a/1
			Specialist	C1	2	III-b
	Sektori i Aplikacioneve	1612	Pergjegjes Sektori	B	1	III-a/1
			Specialist	C1	3	III-b
			Specialist I Nivelit te dyte	C2	1	IV-a
	Sektori i Paisjeve,Matesve dhe Linjave teknologjike	1613	Pergjegjes Sektori	B	1	III-a/1
		Specialist	C1	4	III-b	
Totali Drejtorise					14	
Drejtoria e Metodikave dhe Kontrollit		1620	Drejtor Drejtorie	A	1	III-a
	Sektori I Pijeve Alkolike	1621	Pergjegjes Sektori	B	1	III-a/1
			Specialist	C1	4	III-b
	Sektori i produkteve energjitike	1622	Pergjegjes Sektori	B	1	III-a/1
			Specialist	C1	2	III-b
	Sektori i produkteve te tjera	1622	Pergjegjes Sektori	B	1	III-a/1
		Specialist	C1	2	III-b	
Totali Drejtorise					12	
Totali Departamentit se Akcizes					28	
Departamenti Operativ Hetimor	1300		Zv/Drejtor i Pergjithshem		1	II-b
			Sekretare	C3	1	
Total					2	
Drejtoria Antikontrabandes dhe Rikuperimit me Force te Borxhit me Force	Sektore Antikontrabandes Tokesore	1320	Drejtor Drejtorie	A	1	III-a
		1321	Pergjegjes Sektori	B	1	III-a/1
			Komandante grupi antikontrabande	C1	15	III-b
			Inspektor antikontrabande	C2	38	IV-a
	Sektore Antikontrabandes Detare	1322	Pergjegjes Sektori	B	1	III-a/1
			Komandant motovedete	C1	5	III-b
			Specialist Logjistike (Inxhinjer)	C1	1	III-b
			Specialist Qendres Nderinstitutionale Operacionale Detare	C1	5	III-b
			Inspektor i antikontrabandes detare	C2	15	IV-a
			Magazinjer	D1	1	
			Teknik marine/motorist	D1	5	
			Pergjegjes Sektori	B	1	III-a/1
	Sektore Rikuperimit me Force te Borxhit	1323	Specialist	C1	2	III-b
Totali Drejtorise					91	
Drejtoria Antitrafik		1370	Drejtor Drejtorie	A	1	III-a
			Specialiste i luftes kunder armeve konvencionale dhe demtimit ne mase	C1	2	III-b
			Specialist i luftes Kunder drogave dhe lendeve te tjera	C1	2	III-b
			Specialist I luftes Kunder trafikut te automjeteve dhe veprave te artit	C1	2	III-b

Lidhja nr. 1

Emertimi i postit		Kodi Zyres	Funksioni	Kategoria	Nr. Puno njesve	Kate goria Pages
			Specialisti luftes Kunder parandalimit dhe pastrimit te parave	C1	2	III-b
Totali Drejtorise					9	
Drejtoria e Hetimit			Drejtor Drejtorie	A	1	III-a
			Specialist Hetues	C1	15	III-b
	1332		Oficer Policise Gjyqesore		8	
Totali Drejtorise					24	
Drejtoria per mbrojtjen e Pronesise	1380		Drejtor Drejtorie	A	1	III-a
			Specialist	C1	4	III-b
Totali Drejtorise					5	
Drejtoria e Kontrollave paszhdoganimit (aposteriori)		1340	Drejtor Drejtorie	A	1	III-a
	Sektorit kontrollimit Vleres/klasifikimit/orientimit	1341	Pergjegjes Sektori	B	1	III-a/1
			Specialiste	C1	4	III-b
	Sektorit kontrollit te regjimeve doganore	1342	Pergjegjes Sektori	B	1	III-a/1
			Specialiste	C1	4	III-b
Totali Drejtorise					11	
Drejtoria e Informacionit		1350	Drejtor Drejtorie	A	1	III-a
		1351	Perfaqesues ne SECI	A	1	III-a
	Sektorit Inteligjences Operative		Pergjegjes Sektori	B	1	III-a/1
			Specialiste te Analisteve	C1	1	III-b
			Specialiste kerkimeve	C1	9	III-b
			Specialiste MFF	C1	1	III-b
			Specialiste MTO	C1	1	III-b
			Specialist i Zyres se Evidences Operative	C1	1	III-b
	Sektorit Shkembimit Informacionit	1354	Pergjegjes Sektori	B	1	III-a/1
			Specialiste	C1	6	III-b
Totali Drejtorise					23	
Drejtoriae Analizes se Riskut dhe Monitorimit	Sektorit i Monitorimit	1360	Drejtor Drejtorie	A	1	III-a
			Pergjegjes Sektori	B	1	III-a/1
			Specialiste te Monitorimit	C1	15	III-b
	Sektorit i Analizes se Riskut		Pergjegjes Sektori	B	1	III-a/1
			Specialiste te Analizes se Riskut	C1	4	III-b
Totali Drejtorise					22	
Totali Departamentit Operativ Hetimor					187	
Departamenti Administrativ		1100	Zv/Drejtor i Pergjithshem	II-b	1	II-b
Total					1	
Drejtoria e Menaxhimit te burimeve njerezore		1110	Drejtor Drejtorie	A	1	III-a
	Sektorit i menaxhimit te burimeve njerezore	1111	Pergjegjes Sektori	B	1	III-a/1
			Specialist personeli	C1	2	III-b
			Specialiste trajnimi	C1	2	III-b
	Zyra Sekretari/Protokolli dhe Arkives	1112	Pergjegjes Zyre	C1	1	III-b
			Sekretare/Protokolli	C3	2	
Arkiviste			C3	2		
Totali Drejtorise					11	
Drejtoria e Burimeve Mbeshtetese		1130	Drejtor Drejtorie	A	1	III-a
	Sektorit Logjistike dhe investimesh	1131	Pergjegjes Sektori	B	1	III-a/1
			Specialist investimesh	C1	1	III-b
			Specialist logjistike	C1	3	III-b
			Teknik mirembajtje	D1	1	
			Teknik Mirembajtje (oficina)	D1	4	
			Shofer	D1	14	
			Punonjes pastrimi	D3	5	
	Sektorit Njesise prokurimit	1133	Pergjegjes Sektori	B	1	III-a/1
			Specialiste	C1	2	III-b
Totali Drejtorise					33	
Drejtoria e		1120	Drejtor Drejtorie	A	1	III-a
	Sektorit i Sistemeve dhe sigurise	1121	Pergjegjes Sektori	B	1	III-a/1
			Specialist i sistemeve	C1	3	III-b
			Specialist i sigurise	C1	2	III-b



Lidhja nr. 1

Emertimi i postit		Kodi Zyres	Funksioni	Kategoria	Nr. Puno njesve	Kate goria Pages
Drejtoria e Teknologjise se Informacionit	Sektori i Zhvillimit	1124	Pergjegjes Sektori	B	1	III-a/1
			Specialist I SPDD-se	C1	3	III-b
	Sektori i Zgjidhjeve dhe Suportit (Help Desk)		Specialist I Aplikacioneve te tjera	C1	2	III-b
		1127	Pergjegjes Sektori	B	1	III-a/1
	1128	Specialiste Suporti (Help Desk)	C1	4	III-b	
	Sektori i Analizave	1240	Pergjegjes Sektori	B	1	III-a/1
		Specialiste	C1	3	III-b	
Totali Departamentit Teknologjise dhe Informacionit					22	
Totali Departamentit Administrativ					67	
Totali i Drejtorise se Pergjithshme te Doganave					376	
Drejtorite dhe deget doganore						
Dogana Shkodër	Administrata	3100	Kryetar Dogane	A	1	III-a
			Specialist Analize Risku/Aposterior	C1	1	III-b
			Specialist Jurist/Borxhi	C1	1	III-b
			Specialist Administrator Rrjeti	C1	1	III-b
			Financier	C1	1	III-b
			Sekretari/Arkive/Magazine	C3	1	
			Shofer	D1	1	
			Punetore Mirembajtje	D2	1	
			Punonjes pastrimi	D3	1	
	Zyra Operacioneve Doganore	3110	Pergjegjes Zyre Doganore	C1	1	III-b
			Doganier Peshore/Pike Kontrolli	C3	1	
			Doganier Klasifikim/Vleresim/Kontroll Fizik	C2	3	IV-a
	Zyra e Rregjimeve dhe Akcizes	3110	Pergjegjes Zyre	C1	1	III-b
			Doganier Akcize/Regjime/Preferenca/Perjashtime	C2	3	IV-a
	Zyra Doganore Hani i Hotit	3101	Pergjegjes Zyre Doganore	C1	1	III-b
			Doganier Pike Kontrolli	C3	2	
			Doganier Klasifikim/Vleresim/Kontroll Fizik	C2	9	IV-a
	Zyra Doganore Bajze	3102	Pergjegjes Zyre Doganore	C1	1	III-b
			Doganier Klasifikim/Vleresim/Kontroll Fizik	C2	2	IV-a
	Zyra Doganore Murriq	3103	Pergjegjes Zyre Doganore	C1	1	III-b
			Doganier Pike Kontrolli	C3	4	
			Doganier Klasifikim/Vleresim/Kontroll Fizik			IV-a
			C2	4		
			Puntor Mirembajtes	D2	1	
	Zyra Doganore Vermos	3104	Punonjes pastrimi	D3	1	
			Pergjegjes Zyre Doganore	C1	1	III-b
			Doganier Klasifikim/Vleresim/Kontroll Fizik			IV-a
C2			2			
Totali Deges Doganore					47	
Dogana Lezhe	Administrata	3200	Kryetar Dogane	B	1	III-a/1
			Specialist Analize Risku /Aposterior	C1	1	III-b
			Specialist Jurist/ Borxhi	C1	1	III-b
			Financier	C1	1	III-b
			Sekretari/Arkive/Magazine	C3	1	
			Punonjes pastrimi	D3	1	
			Pergjegjes Zyres Doganore per Operacionet	C1	1	III-b
			Doganier Peshore/Pike Kontrolli	C3	2	

Lidhja nr. 1

Emertimi i postit		Kodi Zyres	Funksioni	Kategoria	Nr. Puno njesve	Kate goria Pages
	Zyra Operacioneve Doganore	3210	Doganier Klasifikim/Vleresim/Kontroll Fizik	C2	4	IV-a
	Doganier Klasifikim/Vleresim/Kontroll Fizik per karburantet		C2	2	IV-a	
	Zyra e Rregjimeve dhe Akcizes		Doganier Akcize/Regjime/Preferenca/Perjashtime	C2	2	IV-a
Totali Deges Doganore					17	
Dogana Bllate (Peshkopi)	Administrata	3300	Kryetar Dogane	B	1	III-a/1
			Specialist Analize Risku /Aposterior/Jurist/Borxhi	C1	1	III-b
			Financier	C1	1	III-b
			Sekretari/Arkive/Magazine	C3	1	
			Punonjes pastrimi	D3	1	
	Zyra Operacioneve Doganore	3310	Pergjegjes Zyre per Operacionet doganore	C1	1	III-b
			Doganier Peshore/Pike Kontrolli	C3	3	
			Doganier Klasifikim/Vleresim/Kontroll Fizik	C2	6	IV-a
	Zyra e Rregjimeve dhe Akcizes		Doganier Akcize/Regjime/Preferenca/Perjashtime	C2	2	IV-a
	Totali Deges Doganore					17
Dogana Kukës (Morine)	Administrata	3400	Kryetar Dogane	B	1	III-a/1
			Specialist Analize Risku /Aposteriori	C1	1	III-b
			Specialist Jurist/Borxhi	C1	1	III-b
			Specialist Administrator Rrjeti	C1	1	III-b
			Financier	C1	1	III-b
			Sekretari/Arkive/Magazine	C3	1	
			Shofere	D1	1	
			Punetor Mirembajtje	D2	1	
	Zyra Operacioneve Doganore	3410	Punonjes pastrimi	D3	1	
			Pergjegjes Zyre Operacioneve Doganore	C1	3	III-b
			Doganier Peshore/Pike Kontrolli	C3	6	
	Zyra e Rregjimeve dhe Akcizes		Doganier Klasifikim/Vleresim/Kontroll Fizik	C2	6	IV-a
			Doganier Akcize/Regjime/Preferenca/Perjashtime	C2	3	IV-a
	Zyra e Skanerit		Doganier Klasifikim/Vleresim/Kontroll Fizik /Skaneri	C2	5	IV-a
	Zyra Doganore Qafe Prush	3401	Pergjegjes Zyre Doganore	C1	1	III-b
			Doganier Klasifikim/Vleresim/Kontroll Fizik	C2	4	IV-a
			Doganier Peshore/Pike Kontrolli	C3	2	
	Zyra Doganore Qafe Morine Tropoje	3403	Pergjegjes Zyre Doganore	C1	1	III-b
			Doganier Klasifikim/Vleresim/Kontroll Fizik	C2	4	IV-a
			Doganier Peshore/Pike Kontrolli	C3	2	
Totali Deges Doganore					46	
	Administrata	3500	Kryetar Dogane	A	1	III-a
			Specialist Analize Risku	C1	1	III-b
			Specialist Aposterior	C1	1	III-b
			Specialist Juriste	C1	2	III-b
			Administrator Rrjeti	C1	1	III-b
			Financier	C1	1	III-b
			Specialist i nivelit te dyte/llogaritar	C2	1	IV-a



Lidhja nr. 1

Emertimi i postit		Kodi Zyres	Funksioni	Kategoria	Nr. Puno njesve	Kate goria Pages
Dogana Tirane			Specialist Borxhi	C1	1	III-b
			Sekretari	C3	1	
			Arkive	C3	2	
			Magazine	D1	1	
			Punonjes pastrimi	D3	1	
	Punetor Mirembajtes	D2	1			
	Zyra e Operacioneve Doganore	3510	Pergjegjes Sektori Operacionesh Doganore	B	1	III-a/1
	Zyra Peshore/Pike Kontrolli	3501	Pergjegjes Zyres Peshore/Pike Kontrolli	C1	1	III-b
			Doganier Peshore/Pike Kontrolli	C3	8	
	Zyra e Akcizes		Pergjegjes Zyres se Akcizes	C1	1	III-b
			Doganier Kontrolli Akcize	C2	9	IV-a
	Zyra Klasifikimi/Vleresimi /Kontrolli Fizik	3502	Pergjegjes Zyres Klasifikimi/Vleresimi/Kontrolli Fizik	C1	1	III-b
			Doganier Klasifikim/Vleresim/Kontroll Fizik	C2	19	IV-a
	Zyra Regjime/Preferenca/Perjashtime	3503	Pegjegjes Zyres Regjime/Preferenca/Perjashtime	C1	1	III-b
			Doganian Kontrolli Regjime/Preferenca/Perjashtime	C2	9	IV-a
Totali Deges Doganore					65	
Dogana Durres	Administrata	3600	Kryetar Dogane	A	1	III-a
			Specialist Analize Risku	C1	1	III-b
			Specialist Aposterior	C1	2	III-b
			Specialist Juriste	C1	3	III-b
			Administrator Rrjeti	C1	1	III-b
			Financier	C1	1	III-b
			Llogaritar/Specialist i nivelit te dyte	C2	1	IV-a
			Specialist Borxhi	C1	2	III-b
			Sekretari	C3	1	
			Arkive	C3	3	
			Magazine	D1	1	
			Shofer	D1	1	
			Punonjes pastrimi	D3	1	
			Punetor Mirembajtje	D2	1	
	Sektori Operacioneve Doganore	3610	Pergjegjes Sektori Operacionesh Doganore	B	1	III-a/1
	Sektori I Skanerit	3601	Pergjegjes Zyre	C1	1	III-b
			Doganier Klasifikim/Vleresim/Kontroll Fizik /Skaneri	C2	5	IV-a
	Zyra Turnit A(Terminalleve Trageteve)	3602	Pergjegjes Zyres	C1	1	III-b
			Doganier Klasifikim/Vleresim/Kontroll Fizik	C2	8	IV-a
			Doganier peshoreje/pike kontrolli	C3	1	
	Zyra Turni B	3603	Pergjegjes Zyres Turni B	C1	1	III-b
			Doganier Klasifikim/Vleresim/Kontroll Fizik	C2	8	IV-a
			Doganier peshoreje/pike kontrolli	C3	1	
	Zyra e Pikes Kontrollit	3604	Pegjegjes Zyres	C1	2	III-b
			Doganier klasifikim/vleresim/kontroll fizik	C2	6	IV-a
			Doganier peshoreje/pike kontrolli	C3	10	
	Zyra Doganore Porto Romano	3605	Pergjegjes Zyres	C 1	1	III-b
			Pergjegjes Turni	C1	2	III-b
			Doganier Klasifikim/Vleresim/Kontroll Fizik	C2	18	IV-a
Pergjegjes Zyre			C1	1	III-b	

Lidhja nr. 1

Emertimi i postit		Kodi Zyres	Funksioni	Kategoria	Nr. Puno njesve	Kate goria Pages
	Zyra e Perpunitimit te Anijeve	3606	Doganier Klasifikim/Vleresim/Kontroll Fizik	C2	10	IV-a
	Zyra e Rregjimeve dhe Akcizes	3607	Pergjegjes Turni	C1	2	III-b
			Doganier Akcize/Regjime/Preferenca/Perjashtime	C2	10	IV-a
	Terminali Konteniereve	3608	Pergjegjes Zyre	C1	2	III-b
			Doganier Klasifikim/Vleresim/Kontroll Fizik	C2	8	IV-a
			Doganier peshoreje/pike kontrolli	C3	2	
Totali Deges Doganore					121	
Dogana Rinas	Administrata	3700	Kryetar Dogane	A	1	III-a
			Specialist Analize Risku /Aposterior	C1	1	III-b
			Specialist Jurist/Borxhi	C1	1	III-b
			Administrator Rrjeti	C1	1	III-b
			Financier	C1	1	III-b
			Sekretare/Arkiviste/Magazinjere	C3	1	
			Shofer	D1	1	
			Punonjes pastrimi	D3	1	
	Zyra Operacioneve Doganore	3710	Pergjegjes Turni Operacioneve Doganore	C1	3	III-b
			Doganier Klasifikim/Vleresim/Kontroll Fizik	C2	26	IV-a
	Sektori Cargo/Regjimesh	3701	Pergjegjes Zyres Cargo/Regjimesh	C1	1	III-b
			Doganieri Klasifikim/Vleresim/Kontroll Fizik/Regjime	C2	6	IV-a
Totali Deges Doganore					44	
Dogana Elbasan	Administrata	3800	Kryetar Dogane	B	1	III-a/1
			Specialist Analize Risku/Aposteriori	C1	1	III-b
			Specialist Jurist/Borxhi	C1	1	III-b
			Administrator Rrjeti	C1	1	III-b
			Financier	C1	1	III-b
			Sekretari/Arkive/Magazine	C3	1	
			Punonjes pastrimi	D3	1	
	Zyra Operacioneve Doganore	3810	Pergjegjes Zyres Operacioneve Doganore	C1	1	III-b
			Doganier Peshore/Pike Kontrolli	C3	3	
			Doganier Klasifikim/Vleresim/Kontroll Fizik	C2	4	IV-a
	Zyra e Rregjimeve dhe Akcizes		Pergjegjes Zyre	C1	1	III-b
			Doganier Akcize/Regjim/Preferenc/Perjashtime	C2	4	IV-a
Totali Deges Doganore					20	
	Administrata	3900	Kryetar Dogane	B	1	III-a/1
			Specialist Analize Risku/Aposteriori	C1	1	III-b
			Specialist Jurist/Borxhi	C1	1	III-b
			Administrator Rrjeti	C1	1	III-b
			Financier	C1	1	III-b
			Sekretare/Arkiviste / Magazine	C3	1	
			Shofer	D1	1	
			Punonjes pastrimi	D3	1	
			Punetor Mirembajtje	D2	2	
	Zyra Operacioneve		Pergjegjes Turni /Pergjegjes Pike Doganore	C1	3	III-b
			Doganier Peshore/Pike Kontrolli	C3	6	



Lidhja nr. 1

Emertimi i postit		Kodi Zyres	Funksioni	Kategoria	Nr. Puno njesve	Kate goria Pages
Dogana Qafe Thane	Doganore	3910	Doganier Klasifikim/Vleresim/Kontroll Fizik	C2	6	IV-a
	Zyra e Rregjimeve dhe Akcizes		Doganier Akcize/Regjime/Preferenca/Perjashtime	C2	3	IV-a
	Zyra e Skanerit		Doganier Klasifikim/Vleresim/Kontroll Fizik /Skaneri	C2	5	IV-a
	Zyra Doganore Tushe	3901	Pergjegjes Turni/Pergjegjes Zyre Doganore	C1	1	III-b
			Doganier Klasifikim/Vleresim/Kontroll Fizik	C2	4	IV-a
			Doganier /peshoreje/pike kontrolli	C3	2	
Totali Deges Doganore					40	
Dogana Korce	Administrata	4000	Kryetar Dogane	B	1	III-a/1
			Specialist Analize Risku/Aposteriori	C1	1	III-b
			Specialist Jurist/Borxhi	C1	1	III-b
			Financier	C1	1	III-b
			Sekretare/Arkiviste / Magazine	C3	1	
			Shofer	D1	1	
			Punonjes pastrimi	D3	1	
	Zyra Operacioneve Doganore	4010	Pergjegjes Zyres operacioneve doganore	C1	1	III-b
			Doganier Peshore/Pike Kontrolli	C3	1	
			Doganier Klasifikim/Vleresim/Kontroll Fizik	C2	2	IV-a
			Pergjegjes Zyre	C1	1	III-b
	Zyra e Rregjimeve dhe Akcizes	4010	Doganier Akcize/Regjime/Preferenca/Perjashtime	C2	4	IV-a
			Pergjegjes Turni/Pergjegjes Zyre Doganore	C1	1	III-b
	Zyra Doganore Gorice	4001	Doganier Klasifikim/Vleresim/Kontroll Fizik	C2	3	IV-a
			Doganier peshoreje/pike kontrolli	C3	3	
Totali Deges Doganore					23	
Dogana Kapshtice	Administrata	4100	Kryetar Dogane	B	1	III-a/1
			Specialist Analize Risku/Aposteriori	C1	1	III-b
			Administrator Rrjeti	C1	1	III-b
			Specialist Jurist/Borxhi	C1	1	III-b
			Financier	C1	1	III-b
			Sekretare/Arkiviste / Magazine	C3	1	
			Punonjes pastrimi	D3	1	
			Punetor Mirembajtje	D2	1	
	Zyra Operacioneve Doganore	4110	Pergjegjes Turni/Pergjegjes Pike Doganore	C1	3	III-b
			Doganier Peshore/Pike Kontrolli	C3	9	
			Doganier Klasifikim/Vleresim/Kontroll Fizik	C2	6	IV-a
			Doganier Akcize/Regjime/Preferenca/Perjashtime	C2	2	IV-a
			Doganier Klasifikim/Vleresim/Kontroll Fizik /Skaneri	C2	5	IV-a
Totali Deges Doganore					33	
			Kryetar Dogane	A	1	III-a

Lidhja nr. 1

Emertimi i postit		Kodi Zyres	Funksioni	Kategoria	Nr. Puno njesve	Kate goria Pages		
Dogana Vlore	Administrata	4200	Specialist Analize Risku/Aposteriori	C1	1	III-b		
			Specialist Jurist/Borxhi	C1	1	III-b		
			Financier	C1	1	III-b		
			Administrator Rrjeti	C1	1	III-b		
			Sekretare/Arkiviste / Magazine	C3	1			
	Zyra Operacioneve Doganore	4210	Punonjes pastrimi	D3	1			
			Pergjegjes Zyres operacioneve Doganore	C1	1	III-b		
			Doganier Peshore/Pike Kontrolli	C3	3			
			Doganier Klasifikim/Vleresim/Kontroll Fizik	C2	9	IV-a		
			Pergjegjes Zyre	C1	1	III-b		
	Zyra e Rregjimeve dhe Akcizes	4201	Doganier Akcize/Regjime/Preferenca/Perjashtime	C2	4	IV-a		
			Zyre Doganore Himare	4201	Pergjegjes Zyre Doganore	C1	1	III-b
Zyra Doganore e Terminalit Bregdetar per depozitim e naftes dhe nenprodukteve ne	4202	Pergjegjes Zyres Doganes	C1	1	III-b			
		Doganier klasifikim/vleresim/kontroll fizik	C2	2	IV-a			
		Doganier Peshore/Pike Kontrolli	C3	3				
Totali Deges Doganore					32			
Dogana Fier	Administrata	4300	Kryetar Dogane	B	1	III-a/1		
			Specialist Analize Risku/Aposteriori	C1	1	III-b		
			Administrator Rrjeti	C1	1	III-b		
			Specialist Jurist/Borxhi	C1	1	III-b		
			Financier	C1	1	III-b		
			Sekretare/Arkiviste / Magazine	C3	1			
			Punetor Mirembajtje	D2	1			
			Sanitar	D3	1			
	Zyra Operacioneve Doganore	4310	Pergjegjes Zyres operacioneve doganore	C1	1	III-b		
			Doganier Peshore/Pike Kontrolli	C3	3			
			Doganier Klasifikim/Vleresim/Kontroll Fizik	C2	4	IV-a		
			Pergjegjes Zyre	C1	1	III-b		
	Zyra e Rregjimeve dhe Akcizes		Doganier Akcize/Regjime/Preferenca/Perjashtime	C2	9	IV-a		
			Totali Deges Doganore				26	
			Dogana Berat	Administrata	4400	Kryetar Dogane	B	1
Specialist Analize Risku/Aposteriori/Jurist/Borxhi	C1	1				III-b		
Financier	C1	1				III-b		
Sekretari/Arkive/Magazine	C3	1						
Punetor Mirembajtje	D2	1						
Punonjes pastrimi	D3	1						
Zyra Operacioneve Doganore	4410	Doganier Peshore/Pike Kontrolli		C3	1			
		Doganier Klasifikim/Vleresim/Kontroll Fizik		C2	2	IV-a		
		Zyra e Rregjimeve dhe Akcizes			Doganier Akcize/Regjime/Preferenca/Perjashtime	C2	3	IV-a
					Totali Deges Doganore			
			Kryetar Dogane	A	1	III-a		
			Specialist Analize Risku/Aposteriori	C1	1	III-b		
			Administrator Rrjeti	C1	1	III-b		



Lidhja nr. 1

Emertimi i postit		Kodi Zyres	Funksioni	Kategoria	Nr. Puno njesve	Kate goria Pages
Dogana Kakavije (Gjirokaster)	Administrata	4500	Specialist Jurist/Borxhi	C1	1	III-b
			Financier	C1	1	III-b
			Sekretare/Arkiviste / Magazine	C3	1	
			Shofer	D1	1	
			Punonjes pastrimi	D3	1	
	Zyra Operacioneve Doganore	4510	Punetor Mirembajtje	D2	1	
			Shef Turni /Pergjegjes Turni	C1	3	III-b
			Doganier Peshore/Pike Kontrolli	C3	9	
			Doganier Klasifikim/Vleresim/Kontroll Fizik	C2	12	IV-a
	Zyra e Skanerit		Doganier Klasifikim/Vleresim/Kontroll Fizik /Skaneri	C2	5	IV-a
Zyra e Rregjimeve dhe Akcizes		Doganier Akcize/Regjime/Preferenca/Perjashtime	C2	3	IV-a	
Totali Deges Doganore					41	
Dogana Saran	Administrata	4600	Kryetar Dogane	B	1	III-a/1
			Specialist Analize Risku/ Aposteriori/Jurist/Borxhi	C1	1	III-b
			Financier	C1	1	III-b
			Administrator Rrjeti	C1	1	III-b
			Sekretari/Arkive/Magazine	C3	1	
			Shofer	D1	1	
			Mirembajtjes	D2	1	
			Punonjes pastrimi	D3	1	
	Zyra Operacioneve Doganore	4610	Pergjegjes Zyres Operacioneve Doganore	C1	1	III-b
			Doganier Peshore/Pike Kontrolli	C3	2	
			Doganier Klasifikim/Vleresim /Kontroll Fizik	C2	2	IV-a
	Zyra Doganore Qaf-Bote	4601	Pergjegjes Turni/Pergjegjes Zyre Doganore	C1	2	III-b
			Doganier Klasifikim/Vleresim /Kontroll Fizik	C2	4	IV-a
			Doganier Akcize/Regjime/Preferenca/Perjashtime	C2	2	IV-a
			Doganier Peshore/Pike Kontrolli	C3	6	
Totali Deges Doganore					27	
Dogana Tri Urat (Permet)	Administrata	4700	Kryetar Dogane	B	1	III-a/1
			Specialist Analize Risku/ Aposteriori/Jurist/Borxhi	C1	1	III-b
			Financier	C1	1	III-b
			Sekretari/Arkive/Magazine	C3	1	
			Punonjes pastrimi	D3	1	
	Zyra Operacioneve Doganore	4710	Pergjegjes Turni/Pergjegjes Zyres Operacioneve Doganore	C1	1	III-b
			Doganier Peshore/Pike Kontrolli	C3	2	
			Doganier Klasifikim/Vleresim /Kontroll Fizik	C2	4	IV-a
	Zyra e Rregjimeve dhe Akcizes		Doganier Akcize/Regjime/Preferenca/Perjashtime	C2	3	IV-a
	Totali Deges Doganore					15
Totali degeve doganore					626	
Totali Administrates Doganore					1002	

URDHËR
Nr. 199, datë 26.10.2013

**PËR NJË SHITESË NË URDHRIN NR. 202, DATË 16.12.2005 TË KRYEMINISTRIT “PËR
FORCIMIN E TRANSPARENCËS, NËPËRMJET RRITJES SË PËRDORIMIT TË
INTERNETIT DHE PËRMIRËSIMIT TË FAQEVE EKZISTUESE TË INTERNETIT”**

Në mbështetje të pikës 3 të nenit 102 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999
“Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”,

URDHËROJ:

Në pikën 4 të urdhrit nr. 202, datë 16.12.2005 të Kryeministrit, pas prapashtesës
identifikuese “gov.al” të shtohen fjalët “...sipas listës që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë
përbërëse e tij.”.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



Dekretet i Presidentit	Domain kryesor	Domain II	Domain aktive	NS	A Record
Zoti Dritmir Bushati, Ministër i Punëve të Jashtme	www.punetejashtme.gov.al		www.mfa.gov.al	AKSHI	134.0.35.147
Zonja Mimi Kodheli, Ministër i Mbrojtjes	www.mbrojtja.gov.al		www.mod.gov.al	AKSHI	134.0.35.189
Zoti Samir Tahiri, Ministër i Punëve të Brendshme	www.punetebrendshme.gov.al		www.moi.gov.al	AKSHI	144.76.67.207
Zonja Klada Gjoshë, Ministër i Integrimit Evropian	www.integrimi.gov.al		www.mie.gov.al	AKSHI	134.0.35.157
Zoti Shkelqim Cani, Ministër i Financave	www.financa.gov.al		www.mintin.gov.al	AKSHI	134.0.35.157
Zoti Edmond Haxhinasto, Ministër i Transportit dhe Infrastrukturës	www.transporti.gov.al	www.infrastruktura.gov.al	www.mprt.gov.al	AKSHI	134.0.35.159
Zonja Egjantina Gjermeni, Ministër i Zhvillimit Urban dhe Turizmit	www.turizmi.gov.al		www.mtkrs.gov.al	AKSHI	134.0.35.148
Zoti Arben Ahmetaj, Ministër i Zhvillimit Ekonomik, Tregëtisë dhe Sipërmarries	www.ekonomia.gov.al		www.mete.gov.al	AKSHI	216.55.105.147
Zonja Lindita Nikolla, Ministër i Arsimit dhe Sportit	www.arsimi.gov.al	www.sporti.gov.al	www.mash.gov.al	AKSHI	216.55.105.147
Zoti Nasip Naco, Ministër i Drejtësisë	www.drejtesia.gov.al		www.justice.gov.al	SAN	134.0.63.98
Zonja Mirela Kumbaro Furxhi, Ministër i Kulturës	www.kultura.gov.al		www.mtkrs.gov.al	AKSHI	134.0.35.203
Zoti Erion Veliqaj, Ministër i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë	www.sociale.gov.al	www.rinia.gov.al	www.mpcs.gov.al	AKSHI	134.0.35.145
Zoti Damian Gjiku, Ministër i Energjisë dhe Industrisë	www.energjia.gov.al		www.mete.gov.al	AKSHI	198.154.228.179
Zoti Edmond Panariti, Ministër i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave	www.bujqesia.gov.al		www.mbumk.gov.al	AKSHI	134.0.35.210
Zoti Ilir Beqja, Ministër i Shëndetësisë	www.shendetesia.gov.al		www.moh.gov.al	hostingalb	69.61.37.54
Zoti Lefter Koka, Ministër i Mjedisit	www.miedisi.gov.al		www.moe.gov.al	AKSHI	134.0.35.208
Zonja Milena Harito, Ministër për Inovacionin dhe Administratën Publike	www.inovacioni.gov.al	www.administrata.gov.al	www.miti.gov.al	AKSHI	216.55.105.147

z. Ilirjan Celibashi Ministër për Marrëdhëniet me Parlamentin

z. Bledi Çupi Ministër Shteti për Çështjet Vendore

VENDIM
Nr. 57, datë 11.9.2013

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR KËMBIMIN E KARTËMONEDHAVE DHE
MONEDHAVE SHQIPTARE TË DËMTUARA”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja “a”, nenit 43, shkronja “c” dhe kreut V të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar; dhe të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Departamentit të Emisionit, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullore “Për këmbimin e kartëmonedhave dhe monedhave shqiptare të dëmtuara”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
 2. Ngarkohet Departamenti i Emisionit në Bankën e Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.
 3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritetit Evropian dhe Komunikimit, për publikimin e kësaj rregulloreje në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë dhe në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.
 4. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohet udhëzimi “Për monedhat e dëmtuara dhe kriteret e këmbimit të tyre”, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 29, datë 30.3.1998.
- Kjo rregullore hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETARI
Ardian Fullani

RREGULLORE
PËR KËMBIMIN E KARTËMONEDHAVE DHE MONEDHAVE SHQIPTARE TË DËMTUARA

KREU I
TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i kriterëve dhe procedurave për këmbimin e kartëmonedhave dhe monedhave shqiptare të dëmtuara dhe tërheqjen e tyre nga qarkullimi.

Neni 2
Baza juridike

- Kjo rregullore nxirret në bazë dhe për zbatim të:
- a) nenit 12, shkronja “a”, nenit 43, shkronja “c” dhe kreut V të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar;
 - b) ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, i cili këtu e më poshtë në këtë rregullore do të quhet “ligji për bankat”.



Neni 3 Subjektet

Subjekte të kësaj rregulloreje janë bankat dhe degët e bankave të huaja të licencuara për të ushtruar veprimtari bankare dhe/ose financiare në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me licencën e lëshuar nga Banka e Shqipërisë.

Neni 4 Përkufizime

1. Për qëllime të zbatimit të kësaj rregulloreje, termit e mëposhtëm do të kenë këto kuptime:

a) “autoritete kompetente” janë autoritetet e zbatimit të ligjit në Shqipëri, të tilla si: Policia e Shtetit, prokuroria etj.;

b) “pajisje antivjedhje” janë pajisjet e instaluar në vendet e depozitimit ose mjetet e transportit të kartëmonedhave, të cilat në rast tentative për vjedhje aktivizohen duke çngjyrosur, njollosur me bojë ose dëmtuar kartëmonedhat në një shkallë të tillë, që i bën të papërdorshme në transaksione *cash*;

c) “pliko” është ambalazhi i mbyllur, i tillë: si zarf, kuti ose qese ku vendosen kartëmonedha ose monedha metalike.

KREU II KËRKESAT PËR KËMBIMIN E KARTËMONEDHAVE DHE MONEDHAVE TË DËMTUARA

Neni 5 Kërkesa të përgjithshme për këmbimin e kartëmonedhave të dëmtuara

1. Banka e Shqipërisë, në përputhje me procedurat e përcaktuara në këtë rregullore, këmben kundrejt vlerës së tyre nominale kartëmonedhat lekë të dëmtuara në rastet kur:

a) ekziston më shumë se 50% e sipërfaqes së kartëmonedhës;

b) ekziston jo më shumë se 50% e sipërfaqes së kartëmonedhës, por kartëmonedha, për arsye madhore që nuk varen nga përdoruesi, është djegur, përmbytur apo dëmtuar dhe pjesët e munguara të kartëmonedhës janë shkatërruar plotësisht.

2. Aplikanti duhet të paraqesë një deklaratë me shkrim që shpjegon burimin e dëmtimit në rastin kur kartëmonedhat e paraqitura për këmbim janë të njollosura me bojë, të ndotura, të përmbytura ose të dëmtuara në mbi 50% të sipërfaqes së tyre.

3. Në rastin kur ekziston jo më shumë se 50% e sipërfaqes së kartëmonedhës, përveç kërkesave të pikës 2 të këtij neni, Banka e Shqipërisë mund t'i kërkojë aplikantit paraqitjen e dokumenteve shtesë nga organet kompetente ose nga organet e pushtetit vendor, mbi burimin dhe rrethanat e dëmtimit.

Neni 6 Kërkesa të përgjithshme për këmbimin e monedhave të dëmtuara

Banka e Shqipërisë, në përputhje me procedurat e përcaktuara në këtë rregullore, këmben kundrejt vlerës së tyre nominale monedhat lekë të dëmtuara në rastet kur ekziston më shumë se 50% e sipërfaqes së monedhës.

Neni 7

Refuzimi për këmbimin e kartëmonedhave ose monedhave të dëmtuara

1. Banka e Shqipërisë do të refuzojë këmbimin e kartëmonedhave dhe monedhave metalike të dëmtuara në rastin kur ka dijeni ose ka arsye të mjaftueshme për të besuar se:

a) kartëmonedhat dhe monedhat metalike të paraqitura për këmbim janë të dëmtuara qëllimisht; ose

b) kartëmonedhat dhe monedhat metalike të paraqitura për këmbim janë përfituar si pasojë e kryerjes së një veprë penale.

2. Kartëmonedhat dhe monedhat metalike të dëmtuara qëllimisht do të konfiskohen pa kompensim dhe do të asgjësohen sipas procedurave të Bankës së Shqipërisë. Kartëmonedhat dhe monedhat metalike me dëmtime të lehta, të tilla: si shënime ose fjalë të shkruara, njolla, vrima apo grisje të lehta, gërvishtje apo deformime të lehta etj., nuk do të konsiderohen si të dëmtuara qëllimisht.

3. Kartëmonedhat dhe monedhat metalike të klasifikuara sipas shkronjës “b” të pikës 1 të këtij neni do të kualifikohen për këmbim vetëm nëse pas verifikimit me autoritetet kompetente përcaktohet se burimi i kartëmonedhave të paraqitura është i ligjshëm.

Neni 8

Kartëmonedhat ose monedhat e dëmtuara qëllimisht

1. Kartëmonedhat ose monedhat e formuara nga bashkimi i dy ose më shumë pjesëve nga kartëmonedha ose monedha të ndryshme do të konsiderohen si kartëmonedha ose monedha të dëmtuara qëllimisht.

2. Kartëmonedhat ose monedhat e cilësuar si të dëmtuara qëllimisht, sipas pikës 1 të këtij neni, do të konfiskohen pa kompensim dhe do të shkatërrohen sipas procedurave në Bankën e Shqipërisë.

Neni 9

Kartëmonedhat e dëmtuara nga pajisjet e sigurisë ose pajisjet për trajtimin dhe shpërndarjen e kartëmonedhave

1. Banka e Shqipërisë, në përputhje me procedurat e përcaktuara në këtë rregullore, këmben kartëmonedhat lekë të dëmtuara nga pajisjet antivjedhje ose pajisjet për trajtimin dhe shpërndarjen e kartëmonedhave.

2. Në rastin e këmbimit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni zbatohen kërkesat e mëposhtme:

a) kartëmonedhat duhet të paraqiten për këmbim në grupe prej 100 copë kartëmonedhash, me kusht që shuma e kartëmonedhave lekë të paraqitura të jetë e mjaftueshme për të formuar grupe të tilla;

b) aplikantët duhet të paraqesin një shpjegim me shkrim mbi shkakun dhe natyrën e dëmtimit.



KREU III KËMBIMI I KARTËMONEDHAVE DHE I MONEDHAVE TË DËMTUARA

Neni 10

Dorëzimi për këmbim i kartëmonedhave dhe i monedhave të dëmtuara

1. Kartëmonedhat dhe monedhat e dëmtuara dorëzohen për këmbim në sportelet e subjekteve, së bashku me kërkesën për këmbim të plotësuar sipas aneksit 1, bashkëngjitur kësaj rregulloreje, si dhe kur është e zbatueshme, çdo dokument tjetër të nevojshëm për përcaktimin e burimit dhe rrethanat e dëmtimit të tyre.

2. Subjektet dërgojnë në Bankën e Shqipërisë, në pliko të mbyllur, kartëmonedhat e dëmtuara së bashku me kërkesën për këmbimin e tyre, jo më vonë se 10 ditë pune nga data e plotësimit të kërkesës nga klienti.

Neni 11

Këmbimi i kartëmonedhave dhe i monedhave në sportel

1. Subjektet, pavarësisht përcaktimeve në pikën 2 të nenit 10 të kësaj rregulloreje, këmbajnë në sportel kundrejt vlerës nominale kartëmonedhat me dëmtime të lehta, të tilla si: shënime ose fjalë të shkruara, njolla, vrima apo grisje të lehta etj.

2. Kartëmonedhat e këmbjera, sipas pikës 1 të këtij neni, dërgohen në Bankën e Shqipërisë së bashku me kartëmonedhat e tjera të rezultuara të papërshtatshme për qarkullim nga procesi i përpunimit.

Neni 12

Këmbimi i kartëmonedhave dhe i monedhave në Bankën e Shqipërisë

1. Kartëmonedhat dhe monedhat e dëmtuara administrohen në Departamentin e Emisionit pranë Bankës së Shqipërisë.

2. Banka e Shqipërisë, brenda 30 ditëve pune nga administrimi i plikove, kryen vlerësimin e kartëmonedhave ose monedhave dhe në përfundim të procesit përcakton sasinë e kartëmonedhave ose monedhave që përmbushin kriteret për këmbim.

3. Vlera e kartëmonedhave dhe monedhave që përmbushin kushtet për këmbim i kalohet personit që i ka dorëzuar nëpërmjet kreditimit të llogarisë së subjekteve.

4. Subjektet sigurojnë që vlera e kartëmonedhave ose e monedhave të këmbjera t'i kalohet menjëherë personit që i ka dorëzuar.

KREU IV DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 13

Dispozitë kalimtare

Kartëmonedhat ose monedhat e dëmtuara të dërguara, për këmbim përpara hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje dhe që pas hyrjes në fuqi nuk janë shqyrtuar akoma, do të trajtohen sipas dispozitave të kësaj rregulloreje.

Neni 14
Masat mbikëqyrëse dhe ndëshkimore

Banka e Shqipërisë, në rast të mosplotësimit nga subjektet të detyrimeve të kësaj rregulloreje, zbaton masat mbikëqyrëse dhe/ose ndëshkimore të parashikuara në ligjin për bankat dhe në aktet e tjera nënligjore në zbatim të tij.

Neni 15
Dispozitë e fundit

Aneksi bashkëlidhur kësaj rregulloreje është pjesë përbërëse e saj.

ANEKSI 1

KËRKESË

**PËR KËMBIMIN E KARTËMONEDHAVE DHE E MONEDHAVE METALIKE
TË DËMTUARA**

Emri				
Mbiemri				
Adresa				
Data				
Numri i telefonit			E-mail	
(Vlera për këmbimin)	Prerjet	Copë	Vlera totale	Për Bankën e Shqipërisë
	1 lek			
	5 lekë			
	10 lekë			
	20 lekë			
	50 lekë			
	100 lekë			
	200 lekë			
	500 lekë			
	1000 lekë			
	2000 lekë			
	5000 lekë			
Totali				

Lutemi jepni të gjitha detajet e dëmtimit të kartëmonedhave/monedhave:

Firma e aplikantit: _____

Data : _____

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2013

Çmimi 25 lekë